



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/02-15767/21  
Kaçanik, 10.06.2021

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI-të (Gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 10 Qershor.2021. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje morën pjesë 7 anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës – Ylber Bajra, drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku, ndërsa nga zyrtarët ishte, Arbnora Kuka, ndërkaq në pjesën e parë të mbledhjes ishte edhe Fatlume Guri- Selimi.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës: Mafire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje për momentin janë 6 anëtarë, ndërkaq Hafize Sallahu tani vjen se më lajmëroj se është duke ardhur, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj hapi mbledhjen e VI-të (Gjashtë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 10 Qershor, me këtë;

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik;
3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër;
4. Ftesa e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, për një vizitë zyrtare të Këshilltarëve të KK Kaçanik, në Komunën e Strugës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Rendin e punës në përbërje prej 4 pikëve.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

#### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së V-të (Pestë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 24.05.2021 /Lënda: 01Nr. 60/01-13538/21.**

2. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Unë kërkoj me tepër sqarime në këtë pikë se, a mos ka pasur ndonjë konflikt përpara me këto prona. Unë kisha thënë që më mirë me iu kompensuar këto 14 m2 me para, sesa me u prishur ajo vija e drejtë, se shtëpia është në vijë të drejtë e ndërtuar. Nëse bëhet shpronësimi, atëherë priset gjeometria e rrugës, rruga e ndryshon vijën e rrugës, ndërkaq fqinjët kanë me pasur telashe me këtë rrugë.

**z. Ukshin Qallaku**, Sqaroj për pjesët që këmbehen, ai nuk e pranon që ajo pronë është rrugë publike, ai pretendon se prona është e tij. Ata munden me u drejtuar në gjykatë për atë punë. Nëse vërtetohet nga gjykata se iu ka marrë në formë të kundërligjshme, ai mundet me kërkuar dëmshpërblim, përndryshe konfliktin e brendshëm nuk mundem me ndalë se nuk mundesh me hequr rrugën. Prona nuk është në emër të tij, por është në emër të komunës, ndërkaq Burhani pretendon se prona është e tij.

**z. Selim Reka**, Unë mendoj së duhet me qenë të kujdesshëm me komunitetin, me biseduar me ta nëse është nevojë. E jona është me bërë zgjidhje e jo me nxitur probleme, bazuar në ligj.

**z. Ukshin Qallaku**, Ne nuk mundem me bërë zgjidhje si thotë ai, rruga është publike, forma qysh e kam marrë nuk e di, a ka lëshuar vet a qysh është bërë bartja unë nuk e di, ndërkaq me u kuptuar me të është e pamundur.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ai pretendon se komplet ajo pjesë e rrugës është e tij dhe nëse ne vendosim një pjesë të rrugës me ia dhënë Misimit, mos po e nxisim ndonjë problem me të madh. D.m.th. një pjesë e shtëpisë është në pronë komunale. Nëse ai e ka të ndërtuar shtëpinë në pronë komunale, ne nuk mund t'i bëjmë tjetër zgjidhje, së komuna nuk ka të drejtë me shitur pronën komunale. Komuna ka të drejtë me ndërtuar pronën, por jo me shitur, e vetmja zgjidhje është këmbimi. Nëse nuk bëhet fjalë për ndonjë pjesë të madhe, atëherë është mirë me shqyrtuar mundësinë e kompensimit me mjete, e mos e mos me prekur pronën komunale të cilën duam me ia dhënë si komunë. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni t'i procedohet kjo pikë Kuvendit të Komunës. Për votuan të gjithë, kështu që konstatohet KPF e,

### Aprovoj

**Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik; dhe e njëjti i,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka hapi diskutimin:

**z. Selim Reka,** Ne nuk mund të bëjë zgjidhje për këtë çështje, sepse procedura shkon në Kuvendin e Komunës.

**z. Ylber Bajra- Nënkyetar Komune,** Sqaroj për përbërjen e komisionit; 3 anëtarë kanë me qenë nga Kuvendi i Komunës, 1 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, ndërkaq 1 anëtar do të jetë nga OJQ e dala nga lufta.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ne jemi vonë për këtë pikë, sepse nëse Presidenti i shpallë Zgjedhjet lokale, nuk kemi të drejtë me proceduar me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Nuk e di sa është afati i këtij komisioni. Vendimi ka edhe procedura tjera, si çështja e ligjshmërisë, pastaj procedura e ankandit publik, aplikimi dhe mundet me zgjat kjo procedurë dhe pa efekt. Nëse vendosim me ia dhënë një pjesë, mos po nxisim probleme me të mëdha.

**z. Ukshin Qallaku,** Ne kemi të drejtë urgjentisht me kërkuar ndërrimin e destinimit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF s e,

### Aprovoj

**Propozim Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër; dhe i njëjti i,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.**

4. Ftesa e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, për një vizitë zyrtare të Këshilltarëve të KK Kaçanik, në Komunën e Strugës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Mua me ka kontaktuar Kryetari i Komunës së Strugës, kam kontakt edhe me esul Kaba, Kryetar i Këshillit të Komunës së Strugës. E hapi diskutimin për këtë pikë:

**znj. Hafize Sallahi,** Pyeti për ditët që do të bëhet vizita zyrtare ?

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ftesa për takim zyrtar është me 8 dhe 9 korrik, dita e enjte dhe e premte sepse nuk mundem me u realizuar vizitë zyrtare ditëve të vikendit. Për shkak të procedurave të prokurimit, vizitën e kemi lënë caktuar në muajin korrik, sepse dihet se procedurat marrin kohë në

zhvillimin e tyre. Për këtë çështje mund të bisedojmë pa protokoll pas mbledhjes. Nëse nuk ka kush diçka, a jeni që kjo pikë t'i adresohet Kuvendit të Komunës. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e, është i pajtimit që,

**Ftesës së Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, për një vizitë zyrtare të Këshilltarëve të KK Kaçanik, në Komunën e Strugës, t'i përgjigjet pozitivisht. Përgjigja pozitive në ftesë, i adresohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:25. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF.**

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 15 Qershor 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli

